



**REPUBLIKA E MAQEDONISË VERIORE**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-187**  
**16. 06.2023**  
**Shkup**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe nenin 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup>, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Zyrtare Gazeta e RMV-së" nr.42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1, datë 29.7.2019, pas zbatimit të Konkursit Publik për dhënie të 1 (një) leje për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel rajonal Shkup, të publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr. 08-96, datë 9.3.2023 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 55/23), dhe në lidhje me Aplikacionin e dorëzuar, Nr.y në PA1 nr. 08-187, datë 15.5.2023, nga kandidati, personi juridik, Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Universiteti i SHKUP-it - Shkup, në përputhje me Raportin nga vlerësimi i aplikimit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel rajonal Shkup, PA1 nr.08-187 nga 13.6.2023 dhe Konkluzionin ark. nr.02-2414/2 datë 15.6. 2023, në seancën e 19 të mbajtur më 15.6.2023, miratoi si vijon:

**V E N D I M**

**për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të  
Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, të destinuara për popullatën studentore,  
në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal Shkup**

**1. I NDAHET** leja për transmetim në radio të shërbimit programor Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, destinuar për popullatën studentore, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv zonë në nivel rajonal të Shkupit (qyteti i Shkupit dhe komunat Çučer Sandevë, Haraçinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopishtë), nga kandidati, personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Universiteti SHKUP - Shkup, me seli në Bul. "Partizanski Odredi" nr.99, 1000 Shkup.

Shërbimi programor në radio nga paragrafi (1) i kësaj pike do të transmetohet nëpërmjet radiofrekuencës përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike e RMV-së, përkatësisht: 106.5 MHz<sup>2</sup>.

**2.** Leja për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, destinuar për popullatën studentore, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal të Shkupit, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i ndahet për një periudhë 9 (nëntë) vjetëçare dhe nuk mund t'i bartet personi tjetër.

**3.** Pas pranimit të këtij Vendimi për dhënie të lejes, kandidati i konkursit, personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP - Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1 e këtij Vendimi, duhet të regjistrojë Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës në regjistrin

<sup>1</sup> Paragrafët (8) dhe (9) janë fshirë, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 248/18).

<sup>2</sup>Sipas përgjigjes së Agjencisë për Komunikim Elektronik të RMV-së pas kërkesës së informacionit për frekuencë të lirë për transmetim të programit në radio në nivel rajonal në zonën e qytetit të Shkupit, ark. nr.0805-217/2 datë 25.1.2023. (Nr.y në ark nr. 08-223/4 datë 31.1.2023), parametrat e dorëzuara teknike sipas të cilave duhet të përpilohet zgjidhje teknike për përfshirjen (mbulimin) e qytetit të Shkupit janë subjekt i ndryshimeve (ndryshimet e mundshme janë të natyrës teknike dhe nënkuptojnë matjet në vend ndodhje nga ana e AKE).

përkatës, në pajtim me nenin 77 paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale.

Institucioni Radiodifuziv Jofitimprurës, i cili do të themelohet nga kandidati i konkursit, personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP - Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1 i këtij Vendimi, do të paguajë tarifë vjetore për lejen në llogarinë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe arkëtimit të taksës Kompensimit) së lejes përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe në përputhje me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së RM-së", nr. 185/14), Rregulloren për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të programeve në radio dhe televizion ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 172/14).

**4.** Agjencia për Komunikime Elektronike në bazë të lejes për transmetim në radio për shfrytëzim të radio frekuencave jep miratim për shfrytëzimin e radio frekuencave në pajtim me Ligjin për Komunikimet Elektronike.

Për përdorimin e radio frekuencave paguhet një tarifë vjetore në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike dhe Rregulloren për mënyrën e llogaritjes së tarifës vjetore për shfrytëzimin e radio frekuencave, të Agjencisë për Komunikime Elektronike të RMV-së ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 192/21), në llogari të Agjencisë për Komunikime Elektronike për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzimin e radio frekuencave.

**5.** Institucioni Radiodifuziv Jofitimprurës, i cili do të themelohet nga kandidati i konkursit, personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Universiteti SHKUP – Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika e këtij Vendimi, deyrohet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë më datë 2.10.2023.

Në rast të mosrespektimit të afatit për fillimin e veprimtarisë nga paragrafi 1 i kësaj pike të Vendimit, Agjencia do të marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilin është dhënë dhe do ta fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

**6.** Personi juridik përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të cilit i është dhënë leja për transmetim në radio, është i detyruar të plotësojë kushtet në tërësi dhe kërkesat për të cilat është angazhuar në Aplikim gjatë konkurimit.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive do të kryejë mbikëqyrje profesionale në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga përfundimi i ditës së tridhjetë nga dita e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë përcaktuar në lejen për transmetim në radio dhe vetëm me qëllim të përcaktimit për plotësimin e kushteve teknike në përputhje me lejen për transmetim në radio.

**7.** Për këtë Vendim do të njoftohet me shkrim pjesëmarrësi i Konkursit Publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel rajonal të Shkupit, subjekti juridik Institucioni i arsimit të lartë privat Universiteti i SHKUP - Shkup, si pjesëmarrës i vetëm në këtë konkurs publik, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

**8.** Ky Vendim është përfundimtar dhe publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

## **A r s y e t i m**

Në bazë të nenit 69 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, për shërbimin programor të radios tokësore që transmetohet nëpërmjet burimi (resursi) të kufizuar siç janë radio frekuencat, Agjencia jep ejen për transmetim në radio nëpërmjet konkursit publik.

Agjencia në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, merr vendim për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio, sipas detyrës zyrtare ose pas pranimit të kërkesës me shkrim nga palë e interesuar,

në pajtim me Planin për dhënie dhe shfrytëzim të radio frekuencave, si dhe në pajtim me Studimin e mënyrës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 70 të ligjit të lartpërmendur.

Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për shpallje të konkursi publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel rajonal, PA1 nr.08-96, datë 9.3.2023 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 55/23), bazuar në Kërkesën me shkrim për dhënie të lejes për Radio jofitimprurëse studentore, nga personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti i Turizmit dhe Menaxhment në Shkup (aktualisht i njohur si Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP - Shkup), për marrje të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel rajonal, Shkup, ark.nr.03-10/1 datë 13.1.2023 (Nr.y në ark. 08-223/1 datë 13.1.2023), Njoftimi i Agjencisë për Komunikime Elektronike të RMV-së lidhur me marrjen e informacionit për frekuencë të mundshme të lirë të radio frekuencës në rajonin e qytetit të Shkupit, ark. nr.0805-217/2 datë 25.1.2023 (Nr.y në ark. 08-223/4 datë 31.1.2023), dhe në pajtim me Studimin e përgatitur për përcaktimin e justifikimit për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për radio jofitimprurëse në nivel rajonal, në zonën e Shkupit, Nr.y në ark.03 - 987/1 datë 3.3.2023.

Afat i fundit për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje në konkursin publik ishte deri më datë 15.5.2023, gjegjësisht kandidatët e konkursit duhet të paraqesin kërkesë brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, llogaritur nga dita e parë vijuese pas datës së publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të RMV-së deri më 15.5.2023 (si afat i fundit për dorëzimin e aplikimeve), drejtuar Agjencisë ishte dorëzuar 1 (një) Aplikacion me dokumentacion shoqëruar për pjesëmarrje në konkursin e cekur publik nga kandidati, personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP – Shkup (PA1 nr.08-187, datë 15.5.2023).

Hapja publike e Aplikacionit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publik në fjalë nga kandidati i lartpërmendur është bërë 1 (një) javë pas skadimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve, respektivisht më datë 22.5.2023, me të cilin aplikacioni i dorëzuar është shqyrtuar nga aspekti se a është i rregullt, në kohë dhe i plotë, gjegjësisht nëse i përmban të gjitha dokumentet e përcaktuara në nenin 73 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të cilat i referohen kandidatit - personit juridik, për të cilin u mbajt Procesverbal nga hapja publike (PA.1 nr.08- 187) datë 22.5.2023.

Në periudhën prej 23.5.2023 deri më datë 12.6.2023, nga ana e sektorëve kompetent në Agjenci është vazhduar me vlerësimin e Aplikacionit të dorëzuar për lëndën konkurs publik (PA1 nr. 08-187, datë 15.5.2023) dorëzuar nga kandidati, personi juridik, Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Universiteti i SHKUP-it. - Shkup. Aplikacioni i dorëzuar brenda afatit të caktuar është vlerësuar nga ana sektorëve kompetente në Agjenci, sipas kriterëve për vlerësimi përcaktuar në tabelën në pikën 5 të Vendimit PA1 nr.08-96, datë 9.3.2023. për shpallje të konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës në nivel rajonal të Shkupit. Sektori për Çështjet Programore ka vlerësuar kriteret nga pika 1, pika 2, pika 3, pika 4 dhe pika 7 e tabelës; Sektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit ka vlerësuar kriterin nga pika 5 e tabelës; Sektori i Financës dhe Logjistikës vlerësoi kriterin nga pika 9 e tabelës dhe Sektori i Mbështetjes Informatike dhe i Punëve të Përgjithshme vlerësoi kriteret nga pika 6, pika 8 dhe pika 10 e tabelës.

U konstatua se Aplikacioni i paraqitur PA1. nr.08-187, datë 15.5.2023 nga kandidati, subjekti juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP - Shkup është i rregullt dhe është vazhduar me vlerësimin dhe notimin e tij. Pra, Sektori për Çështje Programore në kontributin e dorëzuar më 30.5.2023, ka konstatuar se Aplikacioni i kandidatit është i rregullt nga aspekti programor dhe vazhdoi me vlerësimin e mëtejshëm të tij, përkatësisht në: pikën 1 të tabelës – Përfaqësimi i pritshëm i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi ( in-house production( prodhimi i brendshëm) gjatë javës. dhe prodhimi i audioveprave maqedonase, si arsytim për përmbushjen e kriterit, cekti se bëhet fjalë për program 100% i prodhuar nga vetë transmetuesi (pjesa e folur), si dhe se përfaqësimi i parashikuar i programit të prodhuar nga vetë transmetuesi është 100 % aq sa është kohëzgjatja e pjesës së të folurit të programit (11 orë); pika 2 e tabelës - Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjes, si arsytim për plotësimin e kriterit, cekti se në pjesën folëse të programit tregohet se do të përfaqësohen 5 (pesë) lloje programesh që përmbushin funksion informues, edukativ dhe argëtues; pika 3 e tabelës - Përfaqësimi i programeve që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, si arsytim për plotësimin e kriterit, thuhet se është planifikuar të transmetohen 16 orë programe në vit që do të nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, si dhe se përfaqësimi i planifikuar i muzikës vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase gjatë ditës

është 50%; pika 4 e tabelës - Paraqitja e informacionit dhe e përmbajtjes me rëndësi për grupin e synuar nga zona në të cilën do të transmetohet shërbimi programor, gjatë javës, si arsytim për përmbushjen e kriterit theksohej se paraqitja e përfaqësimit e informacioneve dhe përmbajtjeve me rëndësi për të gjithë grupin e zonës në të cilën do të transmetohet shërbimi programor, gjatë javës, në pjesën folëse të programit është 4 orë e 30 minuta; si dhe pika 7 e tabelës - Koha e ofruar e programi të transmetuar ditë, si arsytim për plotësimin e kriterit thuhet se është planifikuar të transmetohet 12 orë program në ditë.

Spektori për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit në kontributin e dorëzuar më 31.5.2023. lidhur me rregullsinë e Aplikacionit, ka konstatuar se në pikën 1.2. nga Aplikacioni – Të dhënat për themeluesin/ it e personit juridik (nëse personi juridik është themeluar nga një person tjetër juridik, duhet të jepen edhe të dhënat për themeluesit e atij personi juridik, derisa të caktohet (arrihet) tek personi fizik), nuk ka të dhëna për personin fizik i cili është pronar i kandidatit - Universiteti i Shkupit, por pas kontrollit në Regjistrin Qendror të RMV-së, është konstatuar se themeluesi i vetëm i Fondacionit për interesa arsimore Kolumbo, i cili është themelues i Universitetit të Shkupit, është personi fizik Ace Milenkovski, i cili ka dhënë deklaratën e nevojshme dhe të noterizuar se kandidati nuk i shkel dispozitat e Kreut IV të LSHMAAV. Gjithashtu, Spektori ka konstatuar se Aplikacioni i kandidatit i plotëson kushtet minimale të personelit(kuadrovike) të parashikuara në nenin 9 paragrafi (3) të Ligjit për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrje të lejes për transmetim në radio dhe televizion (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3747/1 datë 6.10.2022 dhe si shpjegim për plotësimin e kriterit ka theksuar se në pajtim me Aplikacionin, në transmetim do të angazhohe (punësohen) gjithsej 7 persona, 5 prej tyre si gazetarë në BCC dhe ka vijuar mëtej me vlerësimi në pikën 5 të tabelës. - Numrin dhe strukturën e punonjësve që nevojiten për kryerjen e aktivitetit (të paktën 5 punonjës, nga të cilët 3 gazetarë në BCC). Njëkohësisht, Spektori ka kryer kontroll në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe është konstatuar se nuk ka pengesa ligjore për dhënie të lejes për transmetim në radio të Universitetit të Shkupit.

Spektori për Financa dhe Logjistikë në kontributet e dorëzuara më 31.5.2023 dhe më 12.6.2023 ka konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar në Aplikacionin e kandidatit - personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë privat Universiteti SHKUP - Shkup lidhur me aspektin financiar është i plotë, dhe ka dorëzuar Plan biznesi i cili përmban dhe Planin financiar të parashikuar të radios për 3 (tri) vitet në vijim, si garanci ofron për aftësinë financiare për realizimin e veprimtarisë ka dorëzuar pronë të paluajtëshme në pronësi të kërkuesit, me vlerësim të kryer nga vlerësues i autorizuar dhe letër qëllimi nga një bankë komerciale, si dhe aplikanti ka dorëzuar edhe Bilancin e të dhënat dhe gjendjes së të ardhurave për vitin 2020, 2021. dhe 2022 dhe u vazhdua me notimin e mëtejshëm të aplikimit në pikën 9 të tabelës - Aftësia financiare për realizimin e aktivitetit dhe të garanci të ofruara. Spektori i mbështetjes informatike dhe i punëve të përgjithshme në kontributet e dorëzuara më 30.5.2023 . dhe më 7.6.2023 konstatoi se Aplikimi i kandidatit - personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP - Shkup është i rregullt dhe i plotë dhe i është afuar pikëzimit të tij të mëtejshëm , përkatësisht në: pikën 6 të tabelës - Kushtet teknike për prodhimin e programeve, si arsytim për plotësimin e kriterit thuhet se në formularin nr.2, ku plotësohen të dhënat për kushtet teknike për prodhimin e programeve, kandidati ka plotësuar kushtet minimale teknike nga Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion, si dhe ka dorëzuar një projekt teknik i cili është pjesë përbërëse e dokumentacionit të tenderit, pika 8 e tabelës - Kushtet hapësinore për kryerjen e aktivitetit, si arsytim për plotësimin e kriterit ka deklaruar se në të njëjtin Formular nr.2 ku plotësohen të dhënat për kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë, kandidati ka plotësuar kushtet minimale hapësinore në pajtim me Rregulloren për kushtet teknike minimale, hapësinore, kushtet financiare dhe personeli për marrje të lejes për transmetim në radio dhe televizion dhe pika 10 e tabelës - Afati i ofruar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, si arsytim për plotësimin e kriterit, thuhet se në aplikim kandidati ka theksuar si afat për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë ka cekur datën 2.10.2023, që do të thotë mbi 3 ( tre) muaj nga dita e dhënies së lejes.

Në bazë të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer të aplikimit për pjesëmarrje në konkursin publik të kandidatit, subjektit juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP – Shkup, numri i përgjithshëm i pikëve të fituara është përcaktuar të jetë 98 pikë, siç thuhet në Vlerësimin e Raportit për aplikim të dorëzuar për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel rajonal Shkup, PA1 nr. 08-187, datë 13.6.2023, dhe është konstatuar se Aplikimi PA1 nr. 08-187 datë 15.5.2023, i dorëzuar nga kandidati i vetëm, personi juridik Institucioni i Arsimit të

Lartë Privat, Universiteti SHKUP – Shkup, i plotëson kushtet e përcaktuara në konkursin publik në pajtim me Vendimin e Agjencisë për shpalljen e konkursit publik, PA1 nr. 08-96, datë 9.3.2023 (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 55/23 ).

Për të përcaktim të drejtë të fakteve gjatë miratimit të Vendimit për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel rajonal të Shkupit, respektivisht për të përcaktuar nëse ka pengesa ligjore për aplikuesin e Kërkesa për dhënie të lejes për transmetim në radio, Agjencia më 30.5. 2023 dhe më 31.5. 2023 nëpërmjet Sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrit Qendror të RMV-së ka siguruar dokumente nga të cilat shihet se cilat shoqëri tregtare paraqiten si themelues/pronar personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universiteti SHKUP – Shkup, Fondacioni për interesa arsimore Kolumbo Shkup dhe personi fizik Ace Milenkovski, përkatësisht: "Informacione për subjektet e ndërlidhura (personat e autorizuar, organet e menaxhimit, pronarë në subjektet tjera - gjendja aktuale" nr. 0820-50/150020230140065 dt. 30.05.2023, nr. nr.0820-50/150020230141437 datë 31.5.2023 nr.0820-50/150020230141421 datë 31.5.2023, 0820-50/150020230141415 datë 31.5.2023 nr.. 0820-50/150020230140067 datë 30.5.2023, nr.. 0820-50/150020230141424 datë 31.5.2023, nr.0820-50/150020230141428 datë 31.5.2023. Gjithashtu nga Regjistri i pronarëve të vërtetë të Regjistrit Qendror të RMV-së Agjencia më 30.5.2023 dhe më 31.05.2023 ka ofruar këto dokumente, përkatësisht: Gjendjen vijuese të pronarëve të vërtetë të subjektit Republika e Maqedonisë së Veriut - Institucion i Arsimit të Lartë Privat Universiteti i Shkupit Shkup, nr.2005-50/150020230140053 të datës 30.5.2023. dhe Gjendjen vijuese të pronarëve të vërtetë të subjektit Fondacioni për interesa arsimore Kolumbo Shkup, nr.2005-50/150020230141377 të datës 31.5.2023. Nga inspektimi është konstatuar se nuk janë shkelur dispozitat e Kreut IV të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Lidhur me Raportin e vlerësimit të aplikimit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkursin publike për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel rajonal të Shkupit, PA1 nr.08-187 të datës 13.6.2023, Drejtori i Agjencisë, Dr. Zoran Trajčevski, drejtuar Këshillit të Agjencisë dorëzoi Propozim PA1 nr. 08-187, datë 14.6.2023, për marrjen e vendimit për dhënie të lejes për transmetim në radiok të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, destinuar për popullatën studentore, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv - zona në nivel rajonal të Shkupit (qyteti i Shkupit dhe komunat Çuçer Sandevë, Haračinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopishtë), kandidatit, personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Universiteti SHKUP - Shkup , me seli në Bul . “Partizanski odredi” nr.99, 1000 Shkup.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, Këshilli i Agjencisë në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10, dhe në lidhje me nenin 71 paragrafi (1) nënparagrafët 17 dhe 18 dhe neni 75 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe nenin 51 paragrafi (1) të Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, pas zbatimit të Konkursit publik për dhënie të 1 (një) leje për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës , në nivel rajonal të Shkupit, i publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik, PA1 nr.08-96 datë 9.3.2023.(“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 55/23 ), dhe në lidhje me Aplikacionin e dorëzuar, Nr.y në PA1 nr. 08-187, datë 15.05.2023, nga kandidati, personi juridik, Institucioni i Arsimit të Lartë Privat, Universiteti i SHKUP-it - Shkup, në pajtim me Raportin nga vlerësimi i aplikimit të dorëzuar për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës, në nivel rajonal të Shkupit, PA1. nr.08-187 datë 13.6.2023 dhe Konkluzionin ark. nr . 02-2414/2 datë 15.6.2023 , në seancën e 19 të mbajtur më 15.6.2023, miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit të tij do të publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizive  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Pjesëmarrësit në konkursin për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të Institucionit Riodifuziv Jofitimprurës në nivel rajonal në Shkup, i publikuar në bazë të Vendimit të Agjencisë për shpallje të konkursit publik. PA1 nr.08-96 datë 9.3.2023 (“Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 55/23 ), nëse është i pakënaqur nga Vendimi, ka të drejtë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të vendimit të paraqesë padi para në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut .